



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

AKT NORMATIV

Nr. _____, datë _____

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.88/2019,
“PËR BUXHETIN E VITIT 2020”

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në ligjin nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Nenet 1, 2 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Neni 1

Buxheti për vitin 2020 është:

Të ardhurat	489 675 milionë lekë;
Shpenzimet	558 374 milionë lekë;
Deficiti	68 699 milionë lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve.

Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2020 është:

Të ardhurat	358 706 milionë lekë;
Shpenzimet	427 405 milionë lekë;
Deficiti	68 699 milionë lekë.

...

Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore, për vitin 2020, është:

Të ardhurat, gjithsej, 45 304 milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet dhe të tjera	14 416 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	30 888 milionë lekë;
- shpenzimet	45 304 milionë lekë.

Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk tejkalon tavanin prej 11 000 milionë lekësh, përfshirë edhe detyrimet e prapambetura.

Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

Fondi antiCovid-19, prej 2 500 milionë lekësh, detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave, për shpenzime korrente dhe kapitale.”.

Neni 2

Paragrafi i tretë, i nenit 7, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Fondi prej 20 miliardë lekësh shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi, të miratuar në tabelën 1, përmendur në nenin 11, të këtij ligji, si dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar, të miratuar në tabelën 3, përmendur në nenin 15, të këtij ligji.”.

Neni 3

Nenet 9 dhe 10 ndryshohen, si më poshtë vijon

“Neni 9

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	23 000 milionë lekë;
Të ardhurat tatimore	314 121 milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	21 585 milionë lekë.”.

Neni 10

Kufiri i financimit të deficitit të buxhetit të shtetit prej 68 699 milionë lekësh, nëpërmjet huamarrjes totale neto, nga burime të brendshme dhe të huaja, është 72 845 milionë lekë. Brenda këtij kufiri të huamarrjes totale neto përfshihet edhe emetimi i mundshëm i një eurobondi me vlerë indikative prej 80 177 milionë lekësh. Ky kufi i huamarrjes totale neto mund të tejkalohet vetëm në rastet e përcaktuara në nenin 20, të këtij ligji.

Çdo diferencë që mund të rezultojë midis huamarrjes totale neto dhe deficitit të buxhetit të shtetit, në rast teprice akumulohet në llogarinë e qeverisë në Bankën e Shqipërisë ose në rast mungese përdoret nga gjendja e kësaj llogarie.

Në raste pamundësie të financimit të deficitit buxhetor nëpërmjet dy burimeve të mësipërme, Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve.

Të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2020, përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e kufirit të huamarrjes totale neto dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave, për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila, automatikisht, rrit me të njëjtën masë kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2, të këtij ligji.”.

Neni 4

Në nenin 11 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- Shpenzime të buxhetit qendror	414 205 milionë lekë;
---------------------------------	-----------------------

- Fondi rezervë 9 200 milionë lekë;
- Kontingjencë për risqet e borxhit 4 000 milionë lekë.”.

2. Në fund të nenit shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Fondi prej 2 000 milionë lekësh, në zërin “Shpenzime kapitale të brendshme” në programin “Mbështetje për shëndetësinë” të Ministrisë së Mbrojtjes, përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave, për mbështetjen në shërbimin spitalor civil e ushtarak dhe shërbimet komunitare, si për shpenzime korrente ashtu edhe kapitale, mbi kufijtë e përcaktuar në nenin 17, të këtij ligji.”.

Neni 5

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Nnumri i punonjësve bëhet 82 471 veta.
2. Tabela 2, e përmendur në këtë nen, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 6

Neni 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 14

Fondi rezervë i buxhetit prej 9 200 milionë lekësh përdoret nga Këshilli i Ministrave, si më poshtë vijon:

- 1 700 milionë lekë për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme;
- 6 500 milionë lekë si kontingjencë për paketën sociale antiCovid-19;
- 1 000 milionë lekë për emergjenca të tjera në kuadër të masave antiCOVID-19.

Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4 000 milionë lekësh përdoret nga ministri përgjegjës për financat, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.

Shumat e shpërndara nga fondi rezervë i buxhetit dhe kontingjenca për risqet e borxhit shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11, të këtij ligji.”.

Neni 7

Në fund të nenit 15 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Fondet e trashëguara nga vitet e mëparshme përdoren nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas rregullave të përcaktuara nga ministri përgjegjës për financat.”.

Neni 8

Nenet 19 dhe 20 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Neni 19

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të qeverisjes qendrore dhe atij të garantuar të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2020, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, është deri në 84 345 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

- Për huamarrjen totale neto vjetore, përfshirë huamarrjen e brendshme dhe atë të huaj, deri në 72 845 milionë lekë.
- Për rritjen vjetore të garancive të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, deri në 11 500 milionë lekë.

Stoku i borxhit publik vlerësohet të arrijë në 1 197 139 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

- Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore 1 143 036 milionë lekë.
- Stoku i borxhit të garantur nga qeverisja qendrore 53 353 milionë lekë.
- Stoku i borxhit të qeverisjes vendore 750 milionë lekë.

Neni 20

Në rast të emetimit të një eurobondi të ri, vlera e të cilit mund të jetë më e lartë sesa vlera indikative prej 80 177 milionë lekësh, e shprehur në nenin 6, të këtij ligji, si dhe në rast të disbursimit të ndonjë kredie shtesë në formën e “mbështetjes buxhetore” nga institucionet financiare ndërkombëtare, kufijtë respektivë për huamarrjen totale neto, rritjen vjetore të borxhit të qeverisjes qendrore dhe nivelin e vlerësuar të stokut total të borxhit publik, të përcaktuara në nenet 6 dhe 11, mund të tejkalohen deri në shumën e dy vlerave të mëposhtme:

- Diferenca midis vlerës faktike të eurobondit të emetuar dhe vlerës indikative prej 80 177 milionë lekësh.
- Vlera e kredisë në formën e “mbështetjes buxhetore” të disbursuar.

Ndërkohë, niveli i deficitit të buxhetit të vitit 2020 mbetet i pandryshuar, sipas përcaktimit në nenin 1.

Qeveria mund të akumulojë dhe mund të mbajë në llogarinë e qeverisë në Bankën e Shqipërisë çdo gjendje shtesë të likuiditetit që mund të krijohet dhe mbartet për të financuar buxhetet e viteve fiskale pasardhëse, por në mbyllje të vitit buxhetor gjendja e akumuluar nuk duhet të kalojë vlerën mesatare prej dy muajsh kumulativë të shpenzimeve buxhetore.”.

Neni 9

Tabelat 1 dhe 4, bashkëlidhur ligjit, zëvendësohen, përkatësisht, me tabelat me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhen këtij akti normativ.

Neni 10

Ngarkohet ministri përgjegjës për financat që të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij akti normativ.

Neni 11

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA